

EKSTRAKT- VENDIMI

“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur”

Ankuesi i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me një ankesë, në të cilën ngrihen pretendime në lidhje me veprimtarinë e një magjistrate prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor si dhe të magjistratëve gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor dhe atë të Apelit, pasi ankuesi është thirrur si i pandehur në seancën paraprake të caktuar nga gjykata, bazuar në kërkesën e Prokurorisë dhe dërgimin e çështjes në gjyq, dhe zvarritjen e procesit në gjykatën më të lartë.

Ankuesi parashtron se është shoqëruar pa të drejtë nga policia dhe se nga ana e magjistratëve janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin në drejtim të personit të tij, dhe si hakmarrje ndaj denoncimeve të bëra nga ana e tij në një emision investigativ. Gjithashtu ai pretendon se për çështjen në fjalë prokurorja në bashkëpunim me avokatin e tij, kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata. Ankuesi ka bërë ankim në Gjykatën më të lartë, e cila nuk e ka shqyrtuar akoma dhe është duke e zvarritur procesin.

Referuar kushteve të pranueshmërisë së ankesës rezulton, se ajo nuk është bërë në formën e përcaktuar të nenit 120/1 shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi përmban gjeneralitetet e ankuesit, por nuk përshkruhen rrethanat e faktit që pretendohen të kenë ndodhur, si dhe nuk identifikohen sjellje të parashikuara si shkelje disiplinore nga ana e magjistratëve, të cilat janë objekt i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe pretendimet e ankuesit, janë pretendime të pashoqëruara me argumente dhe prova konkrete në lidhje me veprimtarinë gjyqësore apo hetimore të magjistratëve, dhe se nuk pasqyrojnë fakte apo të dhëna të besueshme që ndonjë prej magjistratëve, të kenë kryer shkelje disiplinore, ndërsa përsa i përket çështjes gjyqësore të ankimit në gjykatën më të lartë, ajo është regjistruar dhe se gjyqtarja e çështjes është me status aktual “Në përpunim”.

Nga ana tjetër në rast të cënimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, për shkaqe të cilat përbëjnë njëkohësisht shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 101, 103 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi duhet të riparaqesë ankesë.

Për sa më sipër, ankesa në kohën e shqyrtimit të saj nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë së saj, përsa i përket formës dhe natyrës së pretendimeve të cilat nuk rezultojnë të jenë për sjellje që përbëjnë shkelje disiplinore, duke mos u plotësuar kështu kriteret e pranueshmërisë së ankesës, parashikuara nga neni 120 pika 1 shkronja “a”, “d”, “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për këto arsye,

Bazuar në nenin 121 pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 214 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar,

VENDOSA

1. Arkivimin e ankesës së ankuesit, rregjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj veprimtarisë së magjistratëve.
2. Në zbatim të nenit 121 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ky njoftim t`i njoftohet ankuesit dhe magjistratëve brenda 5 ditëve nga marrja e tij.
3. Kundër këtij vendimi, ankuesi, mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 1 jave nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.